

**RELACION SHPJEGUES  
PËR  
PROJEKTVENDIMIN  
“PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË  
ÇMIMIT TË AKSESIT NË INFRASTRUKTURË DHE ÇMIMET  
REFERUESE TË AKSESIT”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN  
TË ARRIHEN**

Projektakti vjen si propozim i Ministrit për Infrastruturën dhe Energjinë, në zbatim të pikës 6, të nenit 7, të Ligjit Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit*” dhe synon plotësimin e kuadrit të nevojshëm nënligjor të këtij ligji. Ky projektakt ka për qëllim të miratojë metodologjinë e përcaktimit të çmimit të aksesit në infrastrukturë, si dhe çmimet referuese të aksesit.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA  
POLITIKE**

Projektakti vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit*”.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME  
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit*”, në pikën 6, të nenit 7 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në rast refuzimi të së drejtës për akses në infrastrukturë”, ka parashikuar miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit dhe çmimeve referuese për të ndikuar në lehtësimin e ndërtimit të rrjetit të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

**IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE  
HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E  
NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe të pikës 6 të nenit 7 të ligjit Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të*

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit në infrastrukturë dhe çmimet referuese të aksesit”

*komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.*

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projekt akti nuk transpozon ndonjë akt të veçantë të *acquis* së BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKIT**

Projekt akti është i organizuar në 8 nene si më poshtë:

**Në nenin 1** “*Objekti dhe qëllimi*”, përcaktohet objekti i dokumentit dhe qëllimi i tij. Objekt është përcaktimi i metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit në rrjetet e infrastrukturës pasive, si dhe çmimet referuese të aksesit në këto rrjete, me qëllim zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

**Në nenin 2** “*Përkufizime*”, jepen përkufizimet e termave të përdorura në këtë projektakt.

**Në nenin 3** “*Parime të përgjithshme*”, përcaktohen parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet përcaktimi i çmimit të aksesit në rrjetet e infrastrukturës pasive, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga Autoriteti Përgjegjës.

**Në nenin 4** “*Aksesi në infrastrukturën pasive*”, parashikohet se çfarë përfshin dhe çfarë jo, ky akses në infrastrukturën pasive.

**Në nenin 5** “*Përcaktimi i çmimit të aksesit*”, parashikohet me dispozita sesi autoriteti përgjegjës rregullator, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes përcakton çmimin e aksesit bazuar në një nga metodologjitë e këtij akti.

**Në nenin 6** “*Metodologjité për përcaktimin e çmimit të aksesit*”, parashikohen 4 llojet e metodologjive të rekomanduara për përcaktimin e çmimit të aksesit në infrastrukturën pasive.

**Në nenin 7** “*Vendosja e çmimit të aksesit*”, parashtron kërkesat mbi të cilat bazohet vendosja e çmimit të aksesit të rrjetit.

**Në nenin 8** “*Çmimet referuese*”, cilësohet koha për çmimet referuese dhe rishikimi periodik i tyre.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë organet e perçaktuara në nenin 7, të Ligjit Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së*

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin “*Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit në infrastrukturë dhe çmimet referuese të aksesit*”

“kalimit” në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për aksesin në infrastrukturat ekzistuese.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektakti është hartuar nga një grup pune me ekspertë nga tre institucione të përfshira në proces, MIE, AKEP dhe ARSH.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

**MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit në infrastrukturë dhe çmimet referuese të aksesit”